


Restaurimet dhe mirëmbajtja e ikonave fetare si itinerar i turizmit religjioz

Shën Maria



Para restaurimit



Pas restaurimit

Restaurimet dhe mirëmbajtja e ikonave fetare, si pjesë e trashëgimisë kulturore e cila tregon dhe njëherë në sytë e turistëve se fetë në Shqipëri jetojnë në harmoni, po merr vëmendje çdo ditë e më shumë.

Institucionet përkatëse dhe specialistët për mirëmbajtjen e këtyre ikonave po bëjnë restaurimin e tyre për t'i bërë ato të denja për të treguar si vlerën, edhe historinë

që ato bartin.

Në Muzeun e Artit Mesjetar Korçë janë restauruar disa ikona gjatë vitit 2018. Një punë e vyer e specialistëve të fushës, e cila shmang degradimin e mëtejshëm të ikonave si dhe rikthimin e imazhit ikonografik në bukurinë fillestare.

Disa nga ikonat e restauruara gjatë 2018 janë, "Ngjallja e Llazarit", "Zbritja në ferr", "E diela e të verbërit", "Shën Gjergji i Janinës", "Shën Maria" etj.

Kujdesi, mirëmbajtja dhe promovimi i trashëgimisë sonë kulturore është një mision i përbashkët, për t'i përçuar këto pasuri, në mënyrën e duhur, tek brezat e ardhshëm.

Ky është një Muze i veçantë përse i përket numrit të madh të mjeshtërve, autorëve të ikonave (rreth 10 mjeshtër të ikonografisë) dhe larmisë së fondit të objekteve që administron (8000 objekte të Artit Mesjetar, ndër të cilat 6500 janë ikona).

Në godinën e re të muzeut janë ekspozuar rreth 400 ikona nga të cilat 250 ikona i prezantohen publikut për herë të parë. Mënyra e ekspozimit vjen në një frymë bashkëkohore me një rend kronologjik të zhvillimit të mjeshtërisë ikonografike në Shqipëri. Prezantimi i trashëgimisë së Artit Mesjetar të rikthen në gjenezën e mistikes dhe ritualeve të shenjta.


Shën Gjergji i Janinës



Shën Kozmai, Damjani, ???





Para restaurimit




Pas restaurimit

Shërimi i ulokut




Pendikosti



Para restaurimit

Pas restaurimit


E diela e samaritanës



E diela e të verbërit



Para restaurimit



Pas restaurimit

(ATSH)